

Raport Mujor për fondin Credins Premium

Fondi Credins Premium ka objektiv të maksimizojë të ardhurat tuaja, duke ruajtur principalin dhe likuiditetin.. Portofoli i Fondit CREDINS PREMIUM, në përputhje me Politikën e Investimit, do të përbëhet kryesisht nga obligacione dhe bono të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Data e raportit: 30.11.2025

Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	01 Korrik 2016
Monedha e Fondit:	Lek

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë:

- ✓ një normë kthimi më të lartë se produktet bankare,
- ✓ likuiditetin që i mungon këtyre produkteve.

Profil i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Pavarësisht luhatjeve të përkohëshme, historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët				Rrezik i lartë		
Përfitimet tipike më të ulëta				Përfitimet tipike më të larta		
1	2	3	4	5	6	7

Fondi CREDINS PREMIUM ka një profil rreziku në nivelin 2, pra të ulët.

Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	957,143,810.23
Çmimi i kuotës	1,459.9693
Kohëzgjatja e Modifikuar	3.47 vjet
Kthimi nga investimi (30.11.2024-30.11.2025)*	4.94%

* Kostot dhe tarifat e Fondit janë zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond

Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e rikimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i rikimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asete janë të emetuara nga Qeveria, agjencitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti (“rating”) të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

Obligacionet Korporative

Obligacionet korporative janë tituj borxhi të emetuara nga shoqëri private. Këto instrumente përmbajnë riskun e kredisë që mbart shoqëria që emeton. Këto tituj borxhi vlerësohen me risk më të lartë kredie se titujt e borxhit të emetuar nga Republika e Shqipërisë. Këto tituj borxhi ekspozohen ndaj riskut të normave të interesit dhe mbartin një risk të lartë likuiditeti. Fondi investon në tituj korporativ vetëm kur këto janë të emetuara në një treg të rregulluar, siç është Bursa Shqiptare e Titujve ‘ALSE’.

*Për më tepër informacion rreth rreziqeve të Fondit, ju lutem referojuni seksionit përkatës në Prospektin e Fondit Credins Premium.

Kostot dhe Tarifat


Tarifat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë tarifën e administrimit të Shoqërisë Administruese, tarifat e depozitarit, tarifat e AMF, kostot e auditimit vjetor të Fondit, kosto të transaksioneve, etj, si në tabelën e mëposhtme. Tarifa e koston së administrimit dhe të gjitha kostot e tjera të listuara në një vit kontabël nuk do të tejkalojnë në asnjë rast maksimumin prej 1.5% të vlerës neto të asetëve të fondit. Për vitin 2024 tarifa e vazhdueshme ka rezultuar 1.28% e vlerës neto të asetëve të Fondit.

Tarifa e hyrjes apo daljes	0%
Tarifa e administrimit	1% në vit e VNA të Fondit
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	0 Lekë
Kosto të transaksioneve për investimin e asetëve të fondit	sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese
Tarifa e auditimit vjetor të fondit	sipas kushteve të punës së kompanisë së auditit
Tarifa e depozitarit	0.1836% në vit e VNA
Tarifa e AMF	0.05% në vit e VNA

Shpërndarja e Instrumenteve si përqindje e Aseteve Totale të Fondit

Shpërndarja e Instrumentave	ALL	%Aseteve
Obligacione - QSH	781,784,502.52	81.57%
Obligacione Korporative	31,666,660.52	3.30%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	144,962,752.48	15.13%


Shpërndarja e Instrumenteve sipas Llojit



Ankandet e titujve qeveritarë dhe normat e interesit


Qeveria e Republikës së Shqipërisë emeton letrat me vlerë në periudha relativisht të rregullta dhe të shpeshta. Në përputhje me materialet informuese të publikuara nga Ministria e Financave, ankandet për bonot e thesarit me afat 3-mujor dhe 6-mujor organizohen përgjithsisht një herë në muaj, ndërsa ato 12-mujore organizohen çdo dy javë. Gjatë vitit 2025, ankandet e obligacioneve 2-vjeçare, 3-vjeçare dhe 5-vjeçare zhvillohen çdo muaj. Ankandet e obligacioneve 7-vjeçare dy herë çdo tre muaj, 10-vjeçare dhe 15-vjeçare një herë në tre muaj, dhe 20-vjeçare kryesisht çdo 3 muaj.

Ecuria e yield-eve të Bonove 3, 6 dhe 12-mujore



Në datë 11 nëntor u zhvillua ankand për bonon 12-mujore, i cili rezultoi 2.488% nga 2.5% që ishte në tetor. Ndërkohë, gjatë muajit nëntor nuk u zhvilluan ankande për bonon 3-mujore dhe bonon 6-mujore.

Ecuria e yield-eve të Obligacioneve




Në 3 nëntor u zhvilluar ankandi për obligacionin 2-vjeçar i cili rezultoi me normë 2.88% nga 2.92% në shtator. Ankandi i obligacionit referencë 3-vjeçar në datë 18 nëntor, rezultoi me yield 3.887% prej 3.846% në tetor. Ankandi i obligacionit referencë 5-vjeçar në datë 17 nëntor, rezultoi me normë 4.487% nga 4.304% në tetor. Ankandi i obligacionit 7-vjeçar në datë 25 nëntor, rezultoi me normë 4.77% prej 4.69% në tetor. Ankandi i obligacionit 15-vjeçar (rihapje) në datë 12 nëntor, rezultoi me normë 6.19% prej 5.95% në gusht. Gjatë muajit nëntor, nuk u zhvilluan ankande për obligacionet 10-vjeçare dhe 20-vjeçare. Sa i përket ndryshimeve ditore të obligacioneve referencë 3-5 vite, ndryshimet e yield-it nga 31 tetor në 30 nëntor janë si në vazhdim: për 3-vjeçarin e kuotimet mesatare lëvizën nga 3.89% në 3.93%, për 4-vjeçarin nga 4.04% në 4.10% dhe për 5-vjeçarin nga 4.36% në 4.43%.

Kthimi vjetor neto historik

Asetet e Fondit janë kryesisht të investuara në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, dhe si rrjedhojë ecuria e normës së kthimit të Fondit ndikohet nga lëvizja e normave të interesit në ankandet e titujve të Qeverisë Shqiptare. Fondi regjistron obligacionet dhe bonot në portofol sipas vlerës së drejtë, që do të thotë kryen vlerësimin e tyre të tregut çdo ditë. Çmimi i obligacioneve dhe i bonove ka një lidhje të zhdrejtë me normat e interesit. Kur normat e interesit në treg rriten, çmimi (vlera) e dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen. Në rastet kur Fondi investon në obligacione që kanë më pak se 90 ditë deri në maturim, ose në bono thesari me maturitet deri në 90 ditë, instrumenti do të njihet me çmimin e blerjes dhe do të vazhdojë të mbahet me metodën e koston së amortizuar. Kthimet neto të Fondit për pesë vitet e fundit dhe nga themelimi deri më 30 nëntor 2025:

Periudha e qendrimit	Kthimi vjetor i periudhës
1 vjeçare	4.94 % në vit
2 vjeçare	6.10 % në vit
3 vjeçare	4.45 % në vit
4 vjeçare	1.87% në vit
5 vjeçare	2.34 % në vit
Që nga themelimi	3.74% në vit

Norma neto vjetore historike e kthimit




Fondi ka filluar aktivitetin më **1 Korrik 2016**. Norma neto vjetore përfaqëson normën e kthimit të portofolit pasi janë zbritur kostot dhe tarifat që i mbahen fondit. Të dhënat historike paraqiten për qëllime ilustrative dhe nuk duhet të konsiderohen si garanci për të ardhmen.

Inflacioni në vend gjatë muajve janar dhe shkurt të vitit 2025 ka qëndruar në nivel të ulët prej 1.9%, por është pasuar me rritje gjatë gjithë pjesës së vitit duke arritur në nivelin 2.5% në muajin korrik 2025. Gjatë muajit nëntor rezultoi në nivelin 2.1%. Edhe pse rezultati i këtij treguesi ka qenë brenda objektivit prej 3%, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka vendosur të ulë normën bazë në mbledhjen e datës 2 korrik me 0.25%, në nivelin 2.50%. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi të mos e ndryshojë normën bazë në mbledhjen e muajit tetor dhe nëntor 2025. Duke marrë parasysh edhe ecurinë të tjerë treguesve makroekonomikë të deritanishëm, vërehet përmirësim i PPB-së, si edhe një reduktim i raportit të borxhit ndaj të ardhurave. Kjo ecuri zbut riskun e emetuesit, duke zvogëluar riskun e titujve të QSH në të cilat ka investuar fondi.

Në 21 mars 2025, Agjencia Ndërkombëtare "Standard & Poor's" përmirësoi vlerësimin për Shqipërinë në kategorinë 'BB' me perspektivë "të qëndrueshme", nga kategoria 'BB-' që ishte vlerësuar në mars 2024. Gjithashtu, Agjencia Ndërkombëtare e vlerësimit "Moody's" ka konfirmuar në opinion e dhënë në datë 8 Tetor 2025 të njëjtin vlerësim në "Ba3 – e qëndrueshme" për Shqipërinë. Këto vlerësime priten të sjellin rënie të interesave të borxhit sovran në të ardhmen.

Shoqëria Administruese ka ndjekur një strategji alokimi në tituj të maturiteteve të ndryshme, duke mbajtur një kohëzgjatje të përshtatshme të portofolit të titujve dhe njëkohësisht duke ruajtur një shpërndarje të ekuilibruar të maturiteteve të tyre. Më anë të kësaj strategjie shoqëria ka synuar rritjen e normës së kthimit.

Çmimi i Kuotës



Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të fjuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë www.credinsinvest.com.